

Fshatrat dhe bukuritë natyrore përreth Korçës


Voskopoja

Natyrë, arti dhe historia ndërthuren me njëra tjetrën në Voskopojë, duke e bërë këtë vend një destinacion të preferuar turistik përgjatë gjithë vitit. E njohur si qendër e rëndësishme kulturore që në vitin 1330, me kalimin e shekujve ajo u pasurua me mbi 24 kisha, Akademinë e famshme, shtypshkronjën e dytë të Perandorisë Osmane, si dhe plot institucione të rëndësishme të cilat u shkatërruan sa nga zjarret, lufrat, plaçkitjet apo tërmetet. Nga ajo lavdi e së shkuarës, sot mund të admirohen Manastiri i Shën Prodhromit, Kisha katedrale “Fjetja e Shën Marisë”, Kisha e Shën Athanasit, Kisha e Shën Kollit apo disa kisha apo objekte të tjera që mbartin vlera të larta arkitekturore, kulturore e fetare. Në lartësinë e e 1160 metrave mbi nivelin e detit e mbuluar gjatë dimrit me dëborë, kjo është dhe një zonë e mirë për të praktikuar skitë. Vetëm 21 km larg Korçës, në Voskopojë do të gjeni hotele cilësore dhe restorante tradicionale që do e bëjnë akoma më të pëlqyeshëm qëndrimin tuaj aty.



Voskopoja

HOME TO 27 CHURCHES



Dardha


Në lartësinë e 1344 metrave dhe me një peizazh ku karakteristikat e çdo stine pasqyrohen më së miri falë vendndodhjes mes maleve e pyjeve, Dardha është një nga fshatrat turistikë më autentik të Shqipërisë. Shtëpi prej guri, kurora të gjelbërta pyjesh që vishen me të bardhe në dimër, dhe nje pastërti ajri që të mbush mushkëritë e të bën të ndjehesh i rigjeneruar plotësisht. Këto cilësi kanë bërë që në Dardhë vit pas viti të shtohet numri i turistëve, si dhe i atyre banorëve të rinj, që zgjedhin të ndërtojnë shtëpinë ideale të pushimit në këtë fshat 300 vjeçar. Edhe këtu mund të praktikohen skitë prej disa vitesh përmes paketave të posaçme.



Prespë

Vetëm 20 minuta larg nga Korça ndodhet Parku Kombëtar i Prespës, një nga parqet natyrore më të mëdhenj e impresionues të Shqipërisë. Tek sa dy liqenet e mrekullueshëm të Prespës së Madhe dhe Prespës së Vogël, i bëjnë prej 5 milionë vitesh shoqëri njëri tjetrit, tashmë ka ardhur koha që dhe ju t’i vizitoni këto liqene.

Prespa e Madhe me një sipërfaqe prej rreth 300 km katrorë dhe thellësi maksimale 54 m, shtrihet në Shqipëri, Greqi dhe Maqedoni. Ky liqen është i njohur për ujërat e freskëta dhe plazhet me rërë dhe gurë të imët. Disa hotele cilësore dhe bare e restorante ofrojnë të gjitha shërbimet e nevojshme për turistët, ndërkohë që plazhi gjatë verës shoqërohet nga një atmosferë e qetë dhe tejet shplodhëse.



Boboshticë

Ashtu si edhe Voskopoja, e shkuara e Boboshticës ka qënë ajo e një zone mjaft të zhvilluar ekonomike e kulturore. Nga 13 kisha e 3 Manastire që kishte fshati, sot mund të vizitohen kisha e Shën Gjoni Pagëzorit (ndërtuar fillimisht në shek. XII, rindërtua shek. XV), kisha e Shën Mërisë (shek. XVII – shek. XVIII), si dhe kisha e Shën Dhimitrit (shek. XVII). Natyra piktoreske e fshatit, në veçanti manat shekullorë, e bëjnë këtë zonë mjaft tërheqëse. Prej manave prodhohet rakia e famshme e manit, që është ‘suvenir’ perfekt për t’u marrë me vete nga Boboshtica. Fshati njihet dhe për kuzhinën tradicionale të nivelit të lartë, falë tavernave ku gatuhet lakrori i pjekur në saç, petaniku, petullat apo mish i freskët.



Vithkuq

Nga një qendër e zhvilluar e mesjetës, Vithkuqi është sot një fshat i qetë i rrethuar nga gjelbërimi dhe ajri i pastër. Mikëpritja këtu bëhet si njëherë e një kohë, ku miqve u serviret lakrori i shijshëm me dy petë i pjekur në saç. Banorët do të të thonë se Vithkuqi ka qënë fshati i 100 krojeve e 24 kishave. Sot kanë mbijetuar rreth 14 kisha, 6 prej të cilave janë shpallur Monumente Kulture të Kategorisë së Parë. Ndër monumentet që vlen të vizitohen janë Kisha e Shën Mëhillit, e cila tërheq vëmendjen e kujtdo falë harqeve të punuar me mjeshtëri. Kjo kishë mbaroi së ndërtuari në vitin 1728 dhe sot është kisha më e madhe e fshatit. Vithkuqi njihet dhe për një nga bijtë më të shquar të saj, Naum Veqilharxhin, hartuesin e “Evetarit”, abetares së parë shqipe në vitin 1844. Nëse doni të shijoni një pushim absolut majë një kodre, shtëpitë me gur hapen për këdo turist që do të qëndrojë aty, duke ju dhënë mundësinë të njiheni nga afër dhe me banorët mikëpritës të fshatit.

